

Në Victim Support (Ndihmë për Viktimat) ndihemi të tmerruar nga dhuna dhe urrejtjet që kemi parë në ngjarjet e fundit në Mbretërinë e Bashkuar. Protestat dhe sulmet raciste e islamofobike mbi individët dhe komunitetet janë vërtet tronditëse e të papranueshme.

Të prekur nuk janë vetëm këta pjesëtarë të shoqërisë sonë që janë sulmuar fizikisht. Edhe të tjerë që kanë përjetuar sulme raciste, ose që u janë shkatërruar e grabitur pronat.

Shumë njerëz mund të mos kenë përjetuar drejtpërdrejt dhunë fizike ose verbale, por tani jetojnë me frikë – kanë frikë të dalin e të vazhdojnë jetën e tyre.

Askush nuk duhet të jetojë me frikë, ankth dhe dëmtim fizike e emocional të shkaktuar nga urrejtja.

Ne jemi kundër urrejtjes dhe diskriminimit, ndaj me krenari ofrojmë mbështetje për personat e prekur.

Nëse jeni prekur nga ngjarjet e fundit, mund të telefononi falas linjën tonë të asistencës në çfarëdo orari të ditës apo natës në [08 08 16 89 111](tel:08081689111). Ne mund të ofrojmë shërbim përkthimi nëse ndiheni më rehat të flisni në një gjuhë tjetër.